



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:249943

Datë: 07.06.2022

Numri i dokumentit: 03105753

PKR.nr.72/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, nga Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, dhe gjyqtaret Sami Sharraxhiu dhe Shaq Curri, anëtare te trupit Gjykuese, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.GJ nga Peja, për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 prg 1 te KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për krime te renda PP/I.nr. 96/19 të datës 29.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të shtetit Sahide Gashi, të akuzuarit D. Gj dhe mbrojtësit të tij, av. M.I nga Peja, me dt. 03.06.2022 shpalli ndërsa me dt. 07.06.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. Gj, i biri i M dhe nënës L e gjinisë L, i lindur me date në Pejë, me banim ne Peje rruga “ “ nr... , ka të kryer shkollën mesme, i pamartuar , i gjendjes së dobët ekonomike, Boshnjak , Shtetas i R. së Kosovës, gjendet në paraburgim sipas një lënde tjetër.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 31.07.2019, rreth orës 21:40, ne magjistralen V - P, përkatësisht ne lagjen "7 Sh..", pa autorizim posedon me qellim të shpërndarjes substance narkotike të llojit kokaine, ne atë mënyre që, pas një kontrolli rutinë të kryer nga ana e policisë, ne automjetin ".....", me targa:, pronë e shokut të tij A. Ç, i cili edhe po e drejtonte atë automjet, në mes te ulëseve të shoferit dhe pasagjerit, gjejnë një pako te cigareve "M" që i përkiste vet të pandehurit, ku brenda saj kishte tre (3) qese te vogla me substance narkotike te llojit kokainë, me peshë bruto 1.6 gram, të cilën sasi e kishte për qellim t'ua dërgonte tri femrave në P me të cilat do të takohej për t'a konsumuar bashkë, ndërsa nen ulësen e të njëjtit gjejnë një grinder (mulli) të vogël i cili shërben për bluarje te marihuanes, e qe si rrjedhoje e rastit, këtij të fundit i bastiset edhe shtëpia, ku në një dhomë të vogël, është gjetur një sasi e substancës narkotike e llojit marihuanë, në peshë neto prej 0.027 mg, e të cilat substanca janë konfiskuar nga ana e policisë.

-Me çka ka kryer vepër penale “ blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 te KPRK-se.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, dhe nenit 267 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

Për veprën penale si ne dispozitivit të aktakuzës dënim me gjobe në shumë prej 200 €(dyqind euro), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muaj nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë në afat të caktuar atëherë do të shndërrohet në burg ku një ditë burg do të llogaritet për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Te akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit “ kokain “ në sasi prej 1.6 gramë, substanca narkotike e llojit “ marihuana në peshe neto 0.027 gram, një grinder (mulli) i cili shërben për bluarjen të marihuanes, dhe pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit do të shkatërrohen. Të njëjtat gjenden në ruajtje sipas rastit policorë ...-...-....

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale Gjykatës ti paguaj shumën prej 20 (njëzet)€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë)€. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të Renda, ka ngrit aktakuzë PP/L.nr. 96/19 të datës 29.10.2019 kundër të akuzuarit D Gj nga P, për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seanca e shqyrtimit gjyqësore ku ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, dhe i njëjti është deklaruar i pa fajshëm. Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar dhe në seancën e dt.03.06.2022 para se të dëgjohet fjala përfundimtare i akuzuari ka kërkuar ti ipet mundësia të deklarohet për fajësinë për çka gjykata sërish i ka rikujtuar të drejtat e tij dhe pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë.

I akuzuari ka deklaruar se i ka të qarta pasojat dhe përparësitë është konsultuar me mbrojtësin dhe se e pranon fajësinë me vullnet pa ndikim nga askush.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar : “pajtohem plotësisht me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit D e sidomos në këtë fazë të procedurës me te gjitha provat është vërtetuar përtej çdo dyshimit të bazuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale qe i vihet në barrë dhe në të cilën është mbështetur aktakuza”.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. M.I, ka deklaruar: “pajtohem me pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është bërë në konsultim me të si mbrojtës”.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin duke pas parasysh pranimin e fajësisë nga ana e tij si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i oficerit H.N, i përpiluar ne numër te rastit ...-...-..., i dt. 01.08.2019, raporti i oficerit L.E, i përpiluar ne numër te rastit: ...-...-..., i dt. 31.07.2019, intervista e te dyshuarit D Gj, e dhëne pranë DHTN - Peje, me dt. 01.08.2019, intervista e te dyshuarit A Ç, dhënë pranë DHTN - Peje, me dt. 01.08.2019, procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë se te dyshuarit D Gj, i dt. 01.08.2019, dëftesa mbi konfiskimin e pronës nga te dyshuarit D Gj dhe A Ç, e dt. 31.07.2019, dëftesa mbi konfiskimin e pronës nga i dyshuari D Gj, e dt. 01.08.2019, raporti i analizës se narkotikeve, i kryer nga ana e DHTN Peje, ne numër te rastit: ..-...-..., i dt. 04.09.2019, fotografitë, deklarata e te pandehurit D Gj, e dhëne pranë P.TH. - Peje, me dt. 28.10.2019 si dhe shkresat tjera te lendes.

Prokurorja e shtetit ne fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar: “gjykata duhet te merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por prokuroria i propozon gjykatës që më rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal, ti ketë parasysh edhe rrethanat rënduese e në veçanti se kemi të bëjmë me recidivist të veprave penale dhe atë për një periudhe relativisht të shkurtër si dhe për hapjen e madhe te këtyre veprave dhe rrezikun e madhe që paraqet për shoqëri e sidomos për gjeneratat e reja”.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: “pasi i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë kërkojmë nga gjykata që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë posaçërisht lehtësues dhe konform nenit 71 par 1.3 te KPRK-se, të bëjë zbutjen e dënimit, po ashtu nga gjykata të merr parasysh sasinë e narkotikut të konfiskuar dhe konform nenit 72 par 1.4 të bëjë zbutjen e dënimit deri ne 6 muaj.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, i vjen keq dhe nuk kam me përsërit më.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka premtuar se nuk do të përsëris më, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata ka gjet se më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të narkotikëve dhe atë sipas lëndës PKR.nr.3/19 për vepër të njëjtë penale të kryer në vitin 2017 dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 muaj.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka caktuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit konform nenit 71 dhe 72 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me dënim kumulativ (dënim me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi) pasi që për veprën penale që i vihet në barrë parashihet dënim kumulativ, duke konsideruar se dënimet janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit është i bazuar në nenin 267 par.5 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:249943, 07.06.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.